

# PASQYRAT FINANCIARE 2018 EUROMED SHPK

## 1. Informacione te per gjitheshme

Shoqëria Euromed sh.p.k, eshte themeluar si një shoqëri me përgjegjesi të kufizuar ne daten 30.05.2006 me NIPT.K71718012P .

Objekti I veprimitarise se shoqerise eshte Import-Export te paisjeve dhe materialeve elektromjekesore,laboratorike , spitalore , te ndryshme , shitjen e tyre me shumice dhe pakice mirembajtjen dhe servisin e tyre te gjitha operacionet tregetare , industriale dhe financiare ne pasuri te luajtshme te konsideruara te dobjishme dhe te nevojshme ne realizimin e objektit social si dhe te atyre qellimeve qe qofte edhe indirect jane lidhur me te perfshire edhe pjesemarrjen ne shoqeri te tjera qe kane objekt te njejt apo te ngjashem ose ne nje fare menyre jane lidhur direct apo indirect me kete objekt social , dhe dizinfektim , deratizim , dezinsektim ambjentesh .

. Adresa e shoqerise :Tirane ,Bl.Bajram Curri, prane Maternitetit te Ri.

\*Kapitali I shoqerise eshte 35.000.000 leke .Ortate te vetem te shoqerise jane me 90% te kapitait Z.Engjell Hoxha dhe 10% kapitalit Z.Hervin Fora.  
Administrator i Shoqerise Euromed Shpk eshte Z. Engjell Hoxha.

Veprimtaria e Shoqerise rregullohet nga dispozitat e ligjit Nr 9901 date 14.04.2008 "Per tregetaret e shoqerite tregtare",te statutit te shoqerise.

### Deklaratë e pajtueshmërisë me SKK-të

Pasqyrat financiare(individuale) për qëllime të përgjithshme janë përgatitur dhe paraqiten në përputhje me Standardet Kombëtare të Kontabilitetit(SKK-të), të pëmirsuar, dhe me kërkosat e ligjit "Për kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare".

### 2. Bazat e pergatitjes së pasqyrave financiare

Pasqyrat financiare janë përgatitur mbi bazen e parimit te kostos historike, duke e kombinuar me elementetë metodave të tjera, dhe parimit të të drejtave të kostatuara. Ato paraqiten në monedhën vendase, Lekë Shqiptar ("lekë").

### 3. Politikave më të rëndësishme kontabël të zbatuara:

Shenimet qe shpegojne zerat e ndryshem te Pasqyrave Financiare.

Aktivet Afat shkurtra jane ne vleren 224.665.343 leke te detajuara si me poshtë:

### 4. Mjetet monetare 33.595.097 LEKE

Mjetet monetare përfshijnë, mjete monetare në arkë dhe bankë, llogari rrjedhëse, si dhe, investime në tregun e parasë dhe tregje të tjera shumë likuide me kontrata jo më të gjata se tre muaj, të cilat janë objekt i një rreziku jo domethënës të ndryshimeve në vlerë.

Flukset monetare janë hyrjet ose daljet e mjeteve monetare dhe ekuivalentët e mjeteve monetare.

Veprimtari të shfrytëzimit janë aktivitetet bazë të prodhimit të të ardhurave të shoqërise dhe aktivitete të tjera .Gjendjet e llogarive të likuiditeteve të paraqitura ne pasqyrat financiare te viti 2018 konfirmohen me nxjerjet e llogarive bankare dhe inventaret fizike te monedhave ne fund të vitit ushtrimor .Tepricat e shprehura në monedhë të huaj, jane përkthyer ne leke duke përdorur kursin e këmbimit të shpallur nga Banka e Shqipërisë ne daten 31.12.2018



# PASQYRAT FINANCIARE 2018 EUROMED SHPK

Banka							
Nr	Emri i Bankes		Monedha	Nr llogarise		Vlera ne Valute	Kursi fund vitit
<b>LEK SHQIPTAR</b>							
BK Tregtare		Lek	401079372		9.975.040	1	9.975.040
Raiffeisen Bank		Lek	0000072969		1.396.802	1	1.396.802
Credins bank		leke	445962		2.761.546	1	2.761.546
<b>USD</b>							
BK Tregtare		\$	401079372		34.857	107.82	3.758.281
Raiffeisen Bank		\$	0002072969		184	107.82	19.838
Credins bank		\$	558717		994	107.82	107.173
<b>EURO</b>							
Raiffesen Bank		€	0001072969		5.835	123.42	720.155
BK Tregtare		€	401079372		111.233	123.42	13.728.376
<b>GBP</b>							
BK Tregtare		GBP	104079372		0	0	0
Totali							<b>32.467.211</b>
Arka							
Nr	E M E R T I M I				Vlera ne valute	Kursi fund vitit	Vlera ne leke
	Arka ne Leke				1.092.711	1	1.092.711
	Arka ne Euro				285	123.42	35.175
	Arka ne Dollare				0	107.82	0
	Totali						1.127.886

#### 4. Aktivet dhe detyrimet financiare

Një aktiv finanziar ose një detyrim finanziar njihet vetëm kur shoqëria bëhet pjesë e kushteve kontraktuale të instrumentit. Matja fillestare e një aktivi finanziar ose një detyrim finanziar bëhet me kostot e transaksionit (duke përfshirë edhe çimin e trasaksionit) përvèç rasteve kur marrëveshja përbën në thelb, një transaksion finanziar. Një transaksion finanziar mund të jetë, për shembull, kur shiten mallra apo shërbime dhe kur pagesa shtyhet përtëj afateve normale të tregtisë ose kur ajo është financuar me një normë interesë që nuk është një normë tregu. Nëse marrëveshja përbën një transaksion finanziar, matja e aktivit finanziar ose detyrimit finanziar bëhet me vlerën aktuale të pagesave të ardhshme të skontuara me normën e interesit të tregut për një instrument të ngjashëm borxhi.

Në fund të periudhës raportuese, matja e instrumentave finanziarë bëhet si vijon: Instrumentat e borxhit e percaktuara ne pikën 7dhe 8 te SKK-3 (si llogari, dëftesë ose hua e arkëtueshme ose e pagueshme) maten me koston e amortizuar duke përdorur metodën e interesit efektiv. Instrumentat e borxhit që janë të klasifikuar si aktive afatshkurtër ose detyrime afatshkurtër maten me shumën e paskontuar të mjeteve monetare ose shumave të tjera të pritshme për t'u paguar ose arkëtuar, përvèçse kur marrëveshja përbën, në efekt, një transaksion finanziar. Nëse marrëveshja përbën një transaksion finanziar, matja e instrumentit të borxhit bëhet me vlerën aktuale të pagesave të ardhshme të skontuara me një normë tregu interesit për një instrument të ngjashëm borxhi.

Në fund të çdo periudhe raportimi, shoqëria vlerëson nëse ka një evidencë objektive të zhvlerësimit të ndonjë aktivi finanziar që matet me kosto ose me kosto të amortizuar. Nëse ka një evidencë objektive të zhvlerësimit, njihen menjëherë shuma për humbje nga zhvlerësimi në fitim ose humbje.

Nëse, në një periudhë pasuese, shuma e humbjes nga zhvlerësimi zgjedhlohet dhe zgjedhlimi mund të lidhet objektivisht me një ngjarje që ka ndodhur pasi ishte njohur zhvlerësimi (si një përmirësim në vlerësimin e pozicionit finanziar të debitorit), rimerret humbja nga zhvlerësimi të njohur më parë ose direkt ose duke rregulluar një llogari zhvlerësimi, në fitim ose humbje.

Aktivet dhe detyrimet finanziar shoqëria i klasifikon në afatshkurtër dhe afatgjata, bazuar ne percaktimet e SKK-2.



Faqë 2 nga 8

# PASQYRAT FINANCIARE 2018 EUROMED SHPK

## 5. Te drejta te arketueshme .

Nga aktiviteti i qe ushtron Kompania tē drejtat e arketueshme, nē fillim dhe nē fund tē ushtrimit kontabël deklarohen si vijon: Ne “Nga Aktiviteti i Shfrytezimit(Kliente)“ jane pasqyruar faturat e papaguara per sherbimet dhe shitjet e kryera per te cilat nuk eshte bere likuidimi deri me 31.dhjetor 2018. e paraqitur ne bilancin e kompanise ne vleren 127.614.866 leke . Shoqeria Euromed Shpk pret qe kjo vlere e llogarise kerkesa te arketueshme te likujdohet ne vitin pasardhes. Lllogaria te tjera me vleren 21.039.125 leke eshte llogaria rrjedhese e ortakut e pasqyruar ne bilanci deri ne 31.12.2018

## 6.Inventarët

Ne percaktimin e kostos se inventareve eshte zgjedhur metoda FIFO (hyrjet e para daljet e para (SKK -4 )

Fillimi, inventari njihet atëhere kur shoqëria e ka nën kontroll dhe pret përfitime ekonomike prej tij dhe kostoja e tij mund tē vlerësohet me besueshmëri. Njohja e inventarëve bëhet zakonisht nē momentin e përfitimit.

Inventarët maten fillimi me kosto. Kostoja e inventarit përfshin: koston e tē gjitha materialeve tē lidhura drejtpërdrejt me prodhimin si dhe koston e shndërrimit tē këtyre materialeve nē produkte përfundimtare. Kostot e drejtpërdrejta tē materialeve përfshijnë, përvèç çmimit tē blerjes, edhe tē gjitha kostot e tjera që nevojiten për tē sjellë inventarin nē gjendjen dhe vendndodhjen ekzistuese. Kostoja e lëndëve tē para, materialeve tē konsumit, tokës dhe ndërtesave tē blera për rishitje, përbëhet nga çmimi i blerjes, shpenzimet e transportit, taksat e importit, magazinimi, zbritjet dhe shtesat tregtare dhe tē tjera shpenzime tē tjera tē ngjashme (taksat e parimbursueshme).

Pas njoftes, inventari matet me vlerën më tē ulët midis kostos dhe çmimit tē vlerësuar tē shitjes pakësuar me kostot për t'u përfunduar dhe shitur.

Inventarët i nënshtrohen testit tē zhvlerësimit nē datën e raportimit.

Iventari i mallrave qe shoqeria Euromed Shpk ka te gatshem per rishitje ne vitini pasardhes deri ne 31.12.2018 eshte ne vleren 32.143.538 leke .

Vlera 10.272.718 leke eshte parapagim inventari per periudhen ne vazhdim blerje materiale Paisje mjekesore per rishitje per periudhat ne vazhdim.

## 7.Aktivet afatgjata materiale

Aktivet afatgjata materiale(AAM-të) njihen si një aktiv vetëm nëse:aktiv kontrollohet nga shoqëria, është e mundur që përfitme tē ardhshme ekonomike nga përdorimi i aktivit tē hyrë dhe kostoja e aktivit mund tē matet me besueshmëri. Regjistrimi fillestar i AAM-së bëhet zakonisht nē momentin e përfitimit tē tij nga blerja apo prodhimi. Një element i AAM-së, që plotëson kriteret për njoftje si aktiv nē pasqyrën e pozicionit financiar, matet me kosto. Në vlerësimin e mëpasshëm shoqëria zbaton si politikë tē saj kontabël modelin e kostos dhe e aplikon këtë model për tē gjithë klasën e AAM-së që vlerësohet.

Në pasqyrën e pozicionit financiar një element i AAM-së paraqitet me kosto minus amortizimin e akumuluar dhe ndonjë humbje tē akumuluar nga zhvlerësimi. Aktivet materiale ne bilanc Jane paraqitur ne vleren 12.651.761 leke .

Kostot që kanë tē bëjnë me përmirësimet e mëpasshme i shtohen kostos së AAM-së vetëm nëse ato përbushin kriteret e përkufizimit tē AAM-ve dhe kriteret për njoftjen e aktiveve nē pasqyrën e pozicionit financiar. Kostot që lidhen me mirëmbajtjet dhe riparimet e vazhdueshme njihen si shpenzime gjatë vittit ushtrimor

Shoqëria vlerëson nē çdo datë tē raportimit nëse ka ndonjë shenjë që një aktiv mund tē jetë i zhvlerësuar. Nëse ekziston ndonjë shenjë e tillë, ajo vlerëson shumën e rikuperueshme tē aktivit. Nëse nuk ka tē shenja për zhvlerësim, nuk është e nevojshme tē vlerësohet shuma e rikuperueshme.



## PASQYRAT FINANCIARE 2018 EUROMED SHPK

Vlera e amortizueshme e AAM-ve njihet në pasqyrën e të ardhurave, si shpenzim në mënyrë sistematike përgjatë jetës së dobishme të këtij aktivi. Përjashtime bëjnë aktivet afatgjata materiale me jetë të dobishme pa afat si për shembull, toka (përveç minierave dhe vendeve të përdorura përopozoj), punimet e artit me jetë afatgjatë, veprat e muzeve dhe librat të cilat nuk amortizohen.

Amortizimi per te gjitha grupet, llogaritet dhe njihet me *metodën e vlerës së mbetur*, me norma te cilat janë të përafërt me jetegjatesine mesatare te parashikuar te përdorimit. Toka dhe aktivet në proces nuk amortizohen. Normat e përdorura janë ne ndertesa 5 % te dhe per aktivet e tjera 20% dhe 25 % të vlerës së mbetur.

Kostoja, amortizimi i akumuluar dhe vlera kontabël në fillim dhe në fund të vitit ushtrimor për aktivet afatgjata

Emertimi	Toka ,terrene, troje	Ndertim.Instalime pergjithshme	Instalime teknike Makineri Pajisje	Mjete transporti	Pajisje informatike	Pajisje zyre dhe orendi	Totali
<i>Aktive te Trupezuara</i>							
<b>Gjendje 31.12.2017</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>12.869.023</b>	<b>2.946.528</b>		<b>0</b> <b>15.815.551</b>
Shtesa	0	0	0	6.971.245	303.000		0 7.274.245
Pakesime	0	0	0	83.333			0 83.333
<b>Gjendje 31.12.2018</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>17.756.935</b>	<b>3.249.528</b>		<b>0</b> <b>23.006.463</b>
<i>Amortizimi</i>							
<b>Gjendje ne 31.12.2017</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>4.971.276</b>	<b>2.445.545</b>		<b>0</b> <b>7.416.821</b>
Shtesa	0	0	0	2.820.969	125.245		0 2.946.214
Ilogaritur	0	0	0	8.333			8.333
Pakesime	0	0	0				
<b>Gjendje ne 31.12.2018</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>7.783.912</b>	<b>2.570.790</b>		<b>10.354.702</b>
<i>Vlera neto 31.12.2017</i>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>7.897.747</b>	<b>500.983</b>		<b>0</b> <b>8.398.730</b>
<i>Vlera neto 31.12.2018</i>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>11.973.023</b>	<b>678.738</b>		<b>12.651.761</b>

materiale(AAM-të) paraqiten si vijon:

Vlerat dhe klasifikimi ne grupe i AAM-ve te pasqyruara ne bilanc dhe ne tabelen e mesiperme janë te perputhura me te dhenat e inventarizimeve fizike qe shoqeria Euromed Shpk e ka kryer ne fund te muajit dhjetor 2018.

Metoda e zgjedhur e amortizimit të AAM-ve është metoda mbi vlerën e mbetur, e njejtë me atë që perdoret per qellime fiskale. Vlera e AAM e pasqyrauar ne bilanc ne daten 31.12.2018 eshte 2.937.881 leke .

### 8.Detyrime Afatshkurtëra

Detyrimet afateshkurtera ne fillim dhe ne fund te ushtrimit kontabel deri ne 31.12.2018 paraqiten ne vleren **43.121.644** leke e detauar si me poshte:

“Të Pagueshme për Aktivitetin e Shfrytëzimit(furnitore)” rezulton me gjendje ne fund te ushtrimit ne shumen 28.209.977 leke . Shoqeria per kete vlere eshte furnizuar me mallra dhe sherbimi te ndryshme gjate vitit per ushtrimin e aktivitetit te saj . kjo vlere do te paguhet ne vitin pasardhes .

“Të Pagueshme ndaj Punonjësve dhe Sigurime shoq./shëndet.” paraqet detyrimet e mbetur pa u paguar ndaj personelit dhe detyrimin e muajit dhjetor 2018 ne vleren 269.215 leke

Nga te cilat 59.538 leke eshte tatim page , 139.677 leke jane sigurimet shoqerore dhe shendetore .

Dhe 70.000 leke eshte page personeli e pa paguar qe do te paguhet ne janar te viti 2019.

Te pagueshme per detyrimet tatimore jane ne vleren 3.630.577 leke



# PASQYRAT FINANCIARE 2018 EUROMED SHPK

“Të Pagueshme për Detyrime Tatimore “ perbehet nga tatimi mbi vleren e shtuar deri ne 31.12.2018 ne vleren 3.338.518 leke .

“Te pagueshme per detyrimet tatimore “tatim –fitimi per vitin 2018 ne vleren 287.334 leke .  
“ Te pagueshme per tatim ne burim ne vleren 4.725 leke

Detyrimet Afatgjata ndaj institucionit te kredise

Shoqeria ka një detyrim Afatshkurter ne vleren 11.011.875 leke eshte një huamarrje afatshkurter e pagueshme me <12 muaj ndaj Bankes Kombetare Tregetare me vlerë fillestare 18.877.500 leke  
Me afate shlyerje deri ne 12 muaj .

Kompania ka shlyer vleren 7.865.625 leke per periudhen gusht– dhjetor 2018  
Detyrimi i mbetur per tu shlyer eshte ne vleren 11.011.875 leke .

## 10.Kapitali dhe rezervat

Shoqeria ka një kapital total ne vleren 194.195.460 leke i detajuar si me poshte:  
Kapitali i regjistruar i shoqerisë, i paraqitur në pasqyrën e pozicionit finanziar, është i njëjtë me atë të percaktuar ne statutin e shoqerise dhe vendimet e depozituara ne QKR. Deri ne 31.12.2018 ne shumen 35.000.0000 leke.

Kompania ka rezerva ligjore ne vleren 2.958.403leke

Rezerva te tjera qe Shoqeria ka eshte ne vleren 105.351.702 leke

Fitimi neto qe shoqeria ka realizuar per vitit 2018 eshte ne vleren 50.885.355 leke

## 11.Njohja e të ardhurave dhe shpenzimeve

Të ardhurat dhe shpenzimet njihen sipas kontabilitetit të të drejtave të konstatuara. Matja e të ardhurave bëhet me vlerën e drejtë të arkëtar ose të arkëtueshme. Vlera e drejtë e shumës së arkëtar apo për t'u arkëtar merr parasysh shumën e çfarëdo zbritje tregtare, zbritjet për shlyerje të menjëherëshme dhe zbritjet e bëra për sasi (vëllim) të blerë.

Të ardhurat nga shitja e mallrave dhe e produkteve njihen kur janë plotësuar të gjitha kushtet e mëposhtme: i janë kaluar blerësit të gjitha rreziqet dhe përfitimet, që lidhen me pronësinë e mallrave dhe produkteve; shoqëria nuk vazhdon të jetë e përfshirë në mënyrë të vazhdueshme në menaxhimin e mallrave dhe te produkteve në atë masë që tregon se ende zotëron titullin e pronësisë dhe/ose ka kontroll efektiv mbi mallrat/produktet e shitura;shuma e të ardhurave mund të matet me besueshmëri;është e mundur që përfitimet ekonomike, që lidhen me transaksionin, do të merren;kostot që kanë ndodhur, ose që do të ndodhin në lidhje me transaksionin, mund të maten me besueshmëri.


Të ardhurat nga kryerja e shërbimeve njihen kur: shuma e të ardhurave mund të matet me besueshmëri;është e mundshme që përfitimet ekonomike të lidhura me transaksionin do të hyjnë në shoqëri; faza e përfundimit të transaksionit në fund të periudhës raportuese mund të matet me besueshmëri; kostot e ndodhura për shërbimin, si dhe ato që do të ndodhin përfundimin e tij mund të maten me besueshmëri.

Të ardhurat që rrjedhin nga përdorimi nga palë të treta i aktiveve të saj që sjellin interes, përfitim pagesash për përdorime të pronës (rojëlli) dhe dividendë njihen si më poshtë: të ardhurat nga intereseti njihen mbi bazën e metodës lineare ose të metodës së bazuar në normën e brendshme të interesit efektiv; të ardhurat nga shfrytëzimi i pronësisë (rojëlli) njihen mbi bazën e të drejtave dhe detyrimeve të konstatuara, në përputhje me kushtet e kontratës; të ardhurat nga dividendët njihen kur aksionari ka të drejtë ligjore për ta arkëtar atë (dividendin).

Shpenzimet njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve atëherë kur ngjarja detyruese ka ndodhur dhe shoqëria pret të dalin aktive për shlyerjen e tyre në të ardhmen. Shoqëria zbaton parimin e krahasimit të të ardhurave me shpenzimet brenda të njëjtë ushtrim kontabel. Shpenzimet njihen kur kryhen dhe realizohen të ardhura prej tyre, pavarësisht nëse janë faturuar apo paguar.

## 12. Transaksionet me monedhat e huaja

Transaksionet në monedhë të huaj, që plotesojne kushtet në njohje, regjistrohet në monedhën funksionale, duke zbatuar mbi shumën e monedhës së huaj kursin e menjëherëshëm të këmbimit (spot) ndërmjet monedhës funksionale dhe monedhës së huaj në datën e trasaksionit, por shpesh përdoret një kurs këmbimi, i cili është i përafert me kursin e datës së kryerjes së transaksionit, p.sh. një kurs



# PASQYRAT FINANCIARE 2018 EUROMED SHPK

mesatar i një javë ose një muaji mund të përdoret për të gjitha transaksionet e kryera gjatë kësaj periudhe, në secilën prej monedhave të përdorura.

Në fund të çdo periudhe raportuese, zerat ne monedhë te huaj përkthehen si me poshtë: zërat monetarë të shprehur në monedhë të huaj duke përdorur kursin e këmbimit të mbylljes (d.m.th. në datën raportuese); zërat jomonetarë që maten me kosto historike në monedhë të huaj duke përdorur kursin e këmbimit në datën e transaksionit; zërat jomonetarë që maten me vlerën e drejtë në monedhë të huaj duke përdorur kursin e këmbimit në datën kur është përcaktuar vlera e drejtë. Diferencat e këmbimit, që krijojen gjatë shlyerjes së zërave monetarë ose gjatë përkthimit të zërave monetare me kurse këmbimi të ndryshme nga kurset e këmbimit, me të cilat ato janë përkthyer në njohjen gjatë periudhës kontabël aktuale, ose në pasqyrat financiare të mëparshme, njihen si fitim (ose humbje) të periudhës kontabël kur ato lindin

Kur një përfitim ose humbje për një zë jomonetar njihet drejtpërdrejt në kapital, atëherë drejtpërdrejt në kapital do të njihet edhe diferenca e këmbimit. Kurset e këmbimit, të përdorura nga shoqeria për monedhat e huaja më kryesore, më 31.12.2018 Jane 1 euro = 123.42 leke dhe 1 dollar = 107.82 leke.

## 13.Tatimi mbi fitimin

Tatimi mbi fitimin përfshin tatimin e periudhës aktuale dhe tatimin e shtyrë. Tatimi mbi fitimin njihet si shpenzim tatimor në pasqyrën e performancës, përvèç tatimit të zërave që njihen direkt ne kapital,i cili njihet si një zë i kapitalit.

Detyrimi tatimor aktual njihet në vlerat që shoqëria pritet të paguajë (rimbursojë) mbi bazën e normave tatimore dhe ligjeve tatimore që janë miratuar ose janë në thelb të miratuar në datën e raportimit.

Aktivi ose detyrimi tatimor të shtyrë njihet për tatimet e zbritshme (rimbursueshme) ose të pagueshme në periudhat e ardhshme si rezultat i transaksioneve ose ngjarjeve të kaluara. Këto tatime lindin nga ndryshimet mes vlerave të njohura për aktivet dhe detyrimet në pasqyrën e pozicionit financier dhe njohjes së këtyre aktiveve dhe detyrimeve nga autoritetet tatimore, si dhe nga mbartja e humbjeve tatimore dhe e tatimit të zbritshëm (rimbursueshëm) të papërdorur.

Norma aktuale e tatimit mbi fitimin për ushtrimin 2018 eshte 15 % aq sa ka qënë në ushtrimin e mëparshëm.

## 14.Të ardhurat nga aktiviteti i shfrytëzimit dhe të tjera

Te ardhurat nga aktiviteti i shfrytezimit per vitin 2018 shoqeria i ka ne shumen **370.430.257** leke dhe i ka teresisht nga veprimtaria kryesore e saj import export materiale mjekimi paisje mjekesore disinfektim ambjentesh etj.

## 15.Shpenzimet e për lëndë të parë dhe materiale të konsumueshme

Shoqeria Euromed Shpk ka Shpenzimet per periudhen janar – dhjetor 2018 per mallra dhe sherbimi + materiale te konsumueshme paraqiten ne shumen **310.414.470** leke dhe perbehen sipas pasqyres si me posht :

Lende e pare dhe materiale te konsumueshme per periudhen janar – dhjetor 2018 ne veleren 244.658.735 leke .

Shpenzime te tjera ne vleren 41.142.191 leke .

Shpenzime te tjera te shfrytezimit ne vleren 5.212.725 leke

Shpenzime paga punonjesish dhe sigurimet shoqerore + shendetesore janar – dhjetor 2018 Jane ne vleren 10.149.276 leke .

Shpenzime amortizimi ne vleren 2.937.881 leke .

Shpenzime financiare ne vleren 6.313.660 leke

1	Blerje /Shpenzime mallrash te konsumuara gjate vitit deri ne 31.12.2018 (a+b+c+d+e+f+g)	605		244.658.735
a)	Blerje mall	605		229.256.923
b)	Ndryshimi I gjendjes ne 31.12.2018	6035		(3.637.795)
c)	Shpenzime tranporti per blerje	6271		14.648.157



# PASQYRAT FINANCIARE 2018 EUROMED SHPK

d)	Taksa, tarifa doganore(kur perfshihen ne Koston e Blerjes)	632	1.498.606
e)	Akciza (kur perfshihen ne Koston e Blerjes)	633	480.650
f)	Sigurim malli (ku perfshihen ne koston e blerjese) + NGSH	611	1.449.800
g)	Agjensia doganore + tax rregjistrimi <b>Blerje /Shpenzime mallrash te konsumuara gjate viti deri ne 31.12.2018 (a+b+c+d+e+f+g)</b>	6082	962.394
2	Qera		<b>244.658.735</b>
3	Shpenzime karburanti	613	2.118.885
4	Mirrbjatje dhe riparime	6083	2.418.816
5	Sigurime te ndryshme	615	592.446
6		616	934.530
	Reklam , publicitet	624	24.000.000
7	Blerje energjie + avull uji	604	234.540
8	Shpenzime te tjere	608	2.097.453
9	Shpenzime kancelarie +noterizime	6081	1.339.162
10	Transferime , udhetime, + koferanca shpenzime per dieta	625	1.511.055
11		625	4.856.200
12	Shpenzime postare dhe telekomunikimi	626	400.849
13	Shpenzime transporti per shijtet	6272	638.254
	<b>Totali(2+3+4+5+6+7+8+9+10+11+12+13)</b>		<b>41.142.191</b>
1	Sherbime bankare	628	727.785
2	Donacione + ndihma te dhena	653	1.333.170
3	Taksa dhe tarifa vendore	634	206.000
4	Shpenzime per pritje dhe perfaqsime	654	2.092.000
5	Gjoba per vonesa	657	853.770
	<b>Totali (1+2+3+4+5)</b>		<b>5.212.725</b>
	<b>Totali i shpenzimeve</b>		<b>291.013.651</b>

## Shpenzime personeli

Shpenzimet e personelit përbehen nga pagat, kontributet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore, pjesëmarrja në fitime dhe shpërblimet. ne vleren :

Shpenzime personeli	Nr llog	<b>10.149.276</b>
Pagat dhe shperblimet e personelit	641	8.588.500
Sigurimet shoqerore dhe shendetësore	644	1.560.776

Numri mesatar i punonjesve per vitin 2018 eshte 17(persona).

shpenzimet vjetore të kryera për personelin gjate vitit 2018 jane ne veleren 10.149.276 leke .

te detajuara si me posht :

Paga per periudhen janar -dhjetor 2017 eshte 8.588.500 leke

pagesa sigurimet shoqerore + shendetësore per periudhen janar – dhjetor eshte 1.560.776 leke .

## 16. Amortizime dhe zhvleresime ne vleren 2.937.881 leke

Paraqaqiten ne bilanc ne shumen **2.937.881** leke dhe perfaqeson amortizimin vjetor te aseteve automjete + paisje . ( shih pasqyren e llogaritjes se amortizimit).

## 17. Shpenzimet financiare ne vleren 6.313.660 leke

Vlera 5.852.000 leke eshte humbje si diferenca e te ardhurave me shpenzimet sipas kerkesave te standardeve nga luhatjet e kursit te kembimit per periudhen janar – dhjetor 2018 vlera 461.661 leke jane shpenzime per interesa mujore per shlyerje kredie qe shoqeria ka .

## 18. Shpenzimet e tatimit mbi fitimin

Ne vijim janë pasqyruar përbërësit më kryesorë të shpenzimeve (të ardhurave) tatimore të cilat përfshijnë: shpenzimet tatimore aktuale dhe shumën e shpenzimit (të ardhurës) tatimore të shtyrë, që ka të bëjë me krijimin dhe realizimin e diferencave të përkohshme dhe mbartjen e humbjeve.

Fitimi para tatimit per Shoqerin per vitin 2018 eshte	60.015.788
Shpenzime te pa njohura per shoqerin jane	853.770
Fitimi para tatimit eshte	60.869.558
Tatim fitimi per vitin 2018 eshte	9.130.434
Fitimi neto per vitin 2018 eshte	50.885.355



## PASQYRAT FINANCIARE 2018 EUROMED SHPK

Tatimi fitimi i paguar gjate vitit 2018 eshte ne vleren	8.843.100
Tatim fitimi per tu paguar per vitin 2018 eshte	287.334

Në llogaritjen e shpenzimit aktual të tatimit mbi fitimin jane respektuar kerkesat e legjislacionit fiskal.Norma e tatimit mbi fitimin për vitin 2018 eshte 15%.

### 19.Ngjarjet pas dates se bilancit dhe vazhdimesia e shfrytezimit

Asnjë ngjarje e rëndesishme nuk ka ndodhur pas datës së miratimit të pasqyrave financiare.

### 20.Shpjegime mbi palët e lidhura

Me marrjen në konsiderate të çdo transaksi dhe marredhenie të mundeshme, jo thjesht formen ligjore të tyre ne 31 dhjetor 2018 dhe 31 Dhjetor 2017 nuk ka transaksione me palët e lidhura.

### 21.Shifrat krahasuese

Pasqyrat financiare të vitit 2018 janë hartuar dhe paraqitur në përputhje me formatet që janë dhënë në shtojcën e standardit SKK-2,(të përmirësuar) dhe çeljet e vitit 2017 janë riparaqitur sipas këtyre zërave.

Per shoqerine "EUROMED " sh.p.k

ADMINISTRATORI

Engjell Hoxha

